




Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7, paragrafi 4, të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 30; paragrafi 3 të ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 29.12.2023, nxjerrë këtë:



V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-2020/23, për zyrtarin e lartë z. Bexhet Xheladini, Kryetar i Komunës së Dragashit, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Bexhet Xheladini, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se z. Bexhet Xheladini, krahas ushtrimit të funksionit publik si Kryetar i Komunës së Dragashit, është përfaqësues i autorizuar në biznesin "Bexhet Xheladini" B.I.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me shkresën zyrtare DPKI-06-2045/23, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik. Më pas zyrtari i lartë z. Bexhet Xheladini është kontaktuar dhe njoftuar lidhur me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin konkret, si dhe i njëjti është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmer për të shmangur gjendjen e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë përfaqësues i autorizuar në biznes privat e as mbaj funksion drejtues për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohe me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1, lidhur me nenin 15 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të administroj e as drejtoj një biznes privat dhe se të drejtat e drejtimit të ndërmarrjes duhet të i transferoj tek personi i besuar konform nenit 15 të LPKI-së.

Zyrtari i lartë z. Bexhet Xheladini, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka deklaruar se do të ndërmarrë veprime të menjëhershme në mënyrë që të shmang gjendjen e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionin publik.

Ndërkohë, nga qasja publike në regjistrimin e bizneseve në ARBK dhe konfirmimi me institucionet përkatëse, rezulton se zyrtari i lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme, duke u tërhequr nga pozita e përfaqësuesit të autorizuar dhe funksioni drejtues në biznesin e lartpërmendur, përkatësisht duke bartur të drejtat e drejtimit të biznesit të sipërpërmendur tek një person tjetër (personi i besuar).


Pas shqyrtimit të informatave si më lartë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë z. Bexhet Xheladini, është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik konform nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1 dhe 1.3., të LPKI-së.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Ylli Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

